

Bujar Idrizi¹

UDC: 316.774:316.356.2

ROLI I MEDIAS NË FORMËSIMIN E IDENTITETIT FAMILJAR

THE ROLE OF MEDIA IN SHAPING FAMILY IDENTITY

УЛОГАТА НА МЕДИУМИТЕ ВО ФОРМИРАЊЕТО НА СЕМЕЈНИОТ ИДЕНТИТЕТ

Abstract

The media plays an important role in shaping modern family identity, influencing values, communication patterns, and perceptions of familial roles. This paper examines the complex connection between media use and family identity formation, focusing on how traditional and digital media serve as agents of socialization. The study emphasizes how media has a transforming effect on modern families through investigating the relationship between media narratives and family dynamics.

The study starts with a theoretical framework that looks at how media affects family norms and values by referencing sociological and psychological viewpoints. It talks on how stereotypical family roles have historically been portrayed in print and television, which has influenced society expectations. The focus of the study then switches to digital media, especially social media platforms, which, because to user-generated content and worldwide connectivity, have a significant impact on redefining family identity.

This research contains content analysis of media content, social media posts and family influencer accounts.

According to key findings, media greatly shapes ideas on gender roles, parenting practices, and intergenerational relationships, all of which have an impact on family identity. Furthermore, the study shows that media has a double impact on families: it can strengthen bonds and generate shared experiences, but it can also reinforce irrational expectations and drive a wedge between generations.

¹ Student postdiplomik pranë Universitetit Tregtar të Stambollit, drejtimi Komunikimi Institucional

The effects of media on family identity are also discussed in the article, with a focus on the necessity of media literacy initiatives that enable families to interact critically with media.

Keywords: *intergenerational relationship, family identity, family norms, social media*

Roli i medias në formësimin e identitetit familjar në shoqëri

Në kohën tonë, interneti konsiderohet burimi më i fuqishëm që lidhë komunitetet në mbarë botën (Duggan & Smith, 2014). Duke pasur parasysh që njeriu i botës moderne është i lidhur për botën virtuale, me faktin se të gjitha shërbimet e tij në punë apo shkollë janë të lidhura me shërbimet digjitale, është bërë gati se e pamundur që të mendohet një jetë pa lidhje të internetit. Me rritjen e përdorimit të internetit, avancimi i rrjeteve sociale ka krijuar standarde të reja në përditshmërinë tonë, që ka shërbyer si shkak për krijimin e cilësive të reja në personalitetin tonë, duke kontribuar në rritjen e mundësive për të krijuar kontakte të reja ndërpersonale si dhe forcimin e kontakteve familjare në vazhdueshmëri, pa pasur kufizime kohore apo në lokacion, thënë ndryshe, ka sjellë rregulla të reja të socializimit të cilat janë pranuar shumë shpejtë nga përdoruesit e rrjeteve sociale. Krahas ndikimit pozitiv në kontaktet ndërpersonal, media ka kontribuar edhe në ndryshimin e prioritetëve dhe perceptimit tonë ndaj botës reale, e si pasojë kemi edhe lindjen e problematikave të reja sociale. Përdorimi i rrjeteve sociale mundë të analizohet nga këndvështrime të ndryshme. Disa individë i shfrytëzojnë rrjetet sociale për të ndërtuar një jetë sociale më aktive, ndërsa të tjerë i përdorin këto platforma me qëllim të izolimit nga bota e jashtme (Hazar, 2011). Nëse analizojmë përdorimin e rrjeteve sociale nga të rinjtë, mundë të vërejmë se ato përdoren kryesisht për qëllime argëtimi dhe komunikimi, duke përfshirë dërgimin e mesazheve, ndjekjen e zhvillimeve aktuale apo trendeve etj. Megjithëse qëllimet kryesore të përdorimit lidhen me aspektet sociale, përdorimi i rrjeteve për qëllime të zhvillimit personal, si kërkimi i informacioneve apo qasja në njohuri më të thelluara, është mjaft i kufizuar. Rrjetet sociale, të cilat u ofrojnë përdoruesve mundësi për t'u shprehur dhe për të marrë pjesë në jetën sociale, përmes shumëllojshmërisë së përdorimit krijojnë gjithashtu një bazë për zhvillimin e varësisë ndaj rrjeteve sociale (Babacan, 2016: 9). Nga ana tjetër, përdorimi i pakufizuar dhe i pakontrolluar i rrjeteve sociale, të cilat janë të qasshme në çdo kohë dhe vend, sjell me vete një sërë problemesh fizike, sociale dhe psikologjike, ku vlen të theksohet fenomeni “phubbing” e cila i referohet aktit të

injorimit të tjetrit në ambient social dhe fokusimit në rrjetet sociale². Sipas hulumtimeve të ndryshme, phubbing është një lloj sjellje që po rritet në kohët e fundit dhe tani ka më shumë pranim shoqëror, duke u konsideruar si një sjellje normale, në krahasim me të kaluarën kur ajo shihej si një sjellje jo etike. Kjo tregon se sa më shumë njerëzit shfaqin sjellje phubbing, aq më shumë ekziston mundësia që ata të jenë në një shkallë të varësisë ndaj rrjeteve sociale. Me fjalë të tjera, mund të themi se sa më shumë përdoruesit të jenë të prirë për të qëndruar në telefonat e tyre, aq më shumë do të shfaqin sjellje phubbing. Si rezultat, kjo sjellje ndikon në marrëdhëniet familjare dhe shoqërore. Shumë psikologë gjithashtu kanë shprehur shqetësimin e tyre, duke u bazuar në dëshmi empirike, se teknologjia, veçanërisht rrjetet sociale, po shkatërrojnë marrëdhëniet familjare, duke krijuar kështu një boshllëk në jetën personale përmes ndërprerjeve digjitale, duke theksuar se përdorimi i tepërt jo vetëm që i dobëson marrëdhëniet familjare, por gjithashtu dëmton ndjenjën e sigurisë brenda familjeve³. Në epokën e komunikimit digjital dhe të konsumit masiv të informacionit, media është shndërruar në një faktor kyç në strukturimin dhe transformimin e jetës familjare. Narrativet mediatike që përfshijnë përmbajtjet kulturor, kanë ndikuar në mënyrë të qenësishme në mënyrën se si përkufizohet, perceptohet dhe përjetohet familja në shoqëritë bashkëkohore, sepse media nuk luan thjesht rolin e një kanali informues, por është e aftë të ndërtoj standarde të vlerave dhe nxjerrë në pah modele të sjelljeve. Në kontekstin familjar, përmes botës kinematografike, emisioneve televizive, reklamave dhe përmbajtjeve të ndryshme sociale, media luan rol aktiv në prodhimin e botëkuptimeve të reja mbi rolet gjinore, autoritetin prindëror dhe marrëdhëniet ndërpersonale brenda familjes, duke promovuar forma alternative të bashkëjetesës, prindërimit dhe organizimit familjar, siç janë: normalizimi i familjeve me një prind, bashkëjetesa para martesore apo familje me prindër të të njëjtës gjini, e që bien ndesh me modelet tradicionale të familjes, e ku shembull konkret mund të përmendim emisionin ZANAT, i cili transmetohet në televizionin T7 të Republikës së Kosovës e temë diskutimi ka thyerjen e stereotipave të shoqërisë shqiptare dhe ndryshimin e realiteteve gjinore në shoqëri, ndërsa dëshmi më e mirë për këtë tentativë janë titujt eksplicit të emisionit siç janë: Edukimi seksual tek shqiptarët, Si trajtohen burrat dhe gratë në martesë, Sa paragjykohen gratë apo JO familje tradicionale, martesat e hapura dhe emancipimi⁴.

Përdorimi i mediave sociale nga të gjitha grupmoshat ka ndikuar edhe në “rishpërndarjen e pushtetit brenda familjes”, për faktin që, fëmijët dhe

² Roberts, J. A., & David, M. E. (2016). My life has become a major distraction from my cell phone: Partner phubbing and relationship satisfaction among romantic partners. *Computers in Human Behavior*, 54, 134–141.

³ Ali, A., Faraz, M., Memon, J. A., Salman, S. M., & Aziz, A. (2024). The influence of social media usage on quality time spent with family members: Moderating role of family cohesion. *International Research Journal of Social Sciences and Humanities*, 3(1), 930–955.

⁴ https://www.youtube.com/results?search_query=ZANAT

adoleshentët, të cilët janë shpesh më të aftë në përdorimin e teknologjisë digjitale, fitojnë një lloj autonomie që mund të sfidojë autoritetin tradicional prindëror. Në këtë kuptim, media jo vetëm që transmeton përmbajtje, por edhe riprodhon hierarki të reja brenda familjes, duke e bërë marrëdhënien prind-fëmijë më të ndërlikuar për menaxhim dhe më të vështirë për të negociuar.

Portretizimi i roleve stereotipike familjare në media tradicionale dhe ndikimi i mediave digjitale në ripërcaktimin e identitetit familjar

Historikisht, mediat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përhapjen e roleve stereotipike familjare, duke kontribuar në strukturimin e roleve familjare, ku burri është paraqitur si kryefamiljar, punëtor dhe vendimmarrës, ndërsa gruaja si kujdestare e shtëpisë dhe fëmijëve. Megjithatë, me zhvillimin e mediave digjitale, veçanërisht të platformave sociale si Instagram, TikTok, Facebook dhe YouTube, është vërejtur një transformim i rëndësishëm në mënyrën se si paraqiten dhe perceptohen strukturat familjare. Sipas Papacharissi (2010), rrjetet sociale kanë krijuar një “sferë privato-publike”, ku përvojat individuale shpërndahen për audiencë të gjera dhe kështu bëhen pjesë e diskursit publik. Në këtë kontekst, individët nuk janë më vetëm konsumatorë të përfaqësimeve mediatike, por edhe prodhues aktivë të tyre⁵. Ky tranzicion ka kontribuar në “de-normalizimin” e modeleve tradicionale dhe në njohjen e realiteteve të reja familjare, ku nëse marrim ta analizojmë në kontekstin shqiptar, për herë të parë kemi normalizim të portretit të babait i cili krahas karakterit më të “ngurtë” të kujdestarit, luan edhe rolin e “butë” të kujdestarit për fëmijët apo gatimit të ushqimit, nëna që janë aktive në jetën publike dhe krahas kujdesit familjar, posedojnë edhe një karrierë të suksesshme, cilësi këto që në të kaluarën nuk u është dhënë hapësirë mediatike dhe kanë rënë ndesh me stereotipizimin e karakteristikave të prindërve në familje që është shfaqur në mediat tradicionale për një kohë të gjatë. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është ndikimi i rrjeteve sociale në formësimin e identitetit familjar dhe shfrytëzimin e tyre si burim informacioni nga prindërit rreth marrëdhënieve të brendshme familjare, ku si pasojë kemi edhe rritjen e influencerëve familjarë (family influencers) apo edhe lindjen e konceptit “sharenting”⁶, të cilët krijojnë përmbajtje rreth jetës së tyre familjare, aktivitetëve të përditshme, udhëtimeve familjare, këshillave prindërore, sfidave brenda familjes, apo madje edhe momente personale me qëllim që të tërheqin audiencën, dhe duke u bazuar në numrin e ndjekësve të profileve kryesore siç janë: The ACE Family⁷ me 18.2 milionë ndjekës në faqen e tyre në YouTube, The LaBrant Fam⁸ me 12.8

⁵ Papacharissi, Z. (2010). *A Private Sphere: Democracy in a Digital Age*. Polity Press.

⁶ Kombinim i fjalëve “share” dhe “parenting” në gjuhën angleze, që i atribuohet prindërve që vazhdimisht postojnë fëmijët e tyre në rrjetet sociale

⁷ <https://www.youtube.com/@TheACEFamily>

⁸ <https://www.youtube.com/@ColeAndSav>

milionë ndjekës në faqen e tyre në YouTube, apo nëse bëjmë një analizë në kontekstin shqiptar të karaktereve që ndaj eksperiencat e tyre familjare me publikun, do të vërejmë se profile si “Njeriu i Sharrit” dhe “_hatiii” posedojnë qindra mijëra ndjekës në rrjetet e tyre sociale, prandaj, mund të konstatojmë se media po luan një rol aktiv në informimin dhe edukimin familjar, e cila kryesisht ka ndikimin e saj tek gjeneratat e reja të cilët janë të familjarizuar me rrjetet sociale që në moshë të re dhe e kanë më të lehtë të marrin për referencë ngjarjet dhe personalitetet që janë aktivë në botën digjitale. Praktika si marrja për referencë e influencerëve në lidhjet bashkëshortore (në veçanti nga çiftet e reja) dhe raportit prind-fëmijë shpesh kanë edhe rezultate negative në mirëqenien familjare për shkak se mungesa e edukimit të mirëfilltë medial në familje, bën që të harrohet fakti se jeta luksoze e çifteve apo dhuratat e shtrenjta të prindërve influencers, janë vështirë të realizueshme në jetën reale, pa ndihmën e sponsorëve të cilët influencerët i sigurojnë me qëllim reklamimi të produkteve apo bizneseve të caktuara, dhe kjo dërgon në pamjaftueshmëri me gjërat që i posedon familja apo ftohje të raporteve burrë-grua dhe prind-fëmijë, për shkak të mosrealizimit të dëshirave utopike të imponuara nga rrjetet sociale. Në të njëjtën kohë, nëse marrim të analizojmë edhe konceptin e “sharenting” do të shohim se sipas Blum-Ross dhe Livingstone (2017), sharenting mund të ndikojë në autonominë digjitale të fëmijës dhe të kufizojë zhvillimin e një identiteti personal të pavarur⁹, gjithashtu, sharenting shpesh ndërton një “identitet digjital” për fëmijën, para se ai të jetë i aftë për të ndërtuar identitetin e tij. Ky ekspozim i hershëm mund të ndikojë negativisht në mënyrën si fëmijët e shohin veten më vonë. Steinberg (2017) argumenton se e drejta e privatësisë së fëmijëve përballet me sfida serioze për shkak të ndarjes së tepërt të të dhënave nga ana e prindërve¹⁰. Ekspozimi i vazhdueshëm i jetës familjare online i zbeh kufijtë ndërmjet intimitetit dhe publikes. Kjo praktikë, ndryshon natyrën e identitetit familjar duke e zhvendosur nga një hapësirë e brendshme drejt një spektakli të jashtëm, të varur nga reagimet e rrjeteve sociale.

Roli i medias në ndërtimin e marrëdhënieve ndërmjet gjeneratave

Media, e në veçanti rrjetet sociale, kanë një rol esencial në lehtësimin e komunikimit ndërmjet brezave, duke kontribuar ndjeshëm në ndërtimin dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet gjeneratave brenda familjeve moderne. Në një epokë ku anëtarët e familjeve shpesh jetojnë në distanca të konsiderueshme gjeografike, mjetet e teknologjisë mediale bëhen një mjet i pazëvendësueshëm për të mbajtur të forta lidhjet emocionale dhe për të shmangur izolimin social

⁹ Blum-Ross, A., & Livingstone, S. (2017). Sharenting, parent blogging, and the boundaries of the digital self. *Popular Communication*, 15(2), 110–125.

¹⁰ Steinberg, S. B. (2017). Sharenting: Children's privacy in the age of social media. *Emory Law Journal*, 66, 839–884.

të brezave më të vjetër. Platforma si WhatsApp, Facebook, Instagram apo FaceTime kanë ndryshuar mënyrën se si anëtarët e familjeve ndërveprojnë mes tyre. Përmes këtyre platformave, komunikimi është bërë më i shpejtë, më i lehtë dhe më personal. Kjo formë komunikimi jo vetëm që mban të gjalla lidhjet ndërmjet brezave, por gjithashtu rrit intensitetin emocional dhe afërsinë psikologjike (Ivan & Fernández-Ardèvol, 2017). Krahës rritjes së intensitetit emocional, avancimi medial ka kontribuar edhe në ngritjen intelektuale tek gjeneratat më të vjetra të cilët rishtazi kanë pasur mundësin për të pasur qasje më të madhe deri tek informacioni, dhe kjo i ka ndihmuar në përditësimin e informacioneve si dhe thyerjen e stereotipave dhe tejkalimin e barrierave me gjeneratat më të reja rreth ngjarjeve aktuale që i ka preokupuar, gjithashtu, të rinjtë shpesh bëhen edukatorë të gjeneratave më të vjetra, duke i ndihmuar ata të orientohen në botën digjitale, gjë që përmirëson komunikimin dhe mirëkuptimin mes brezave. Nga ana tjetër, media mund edhe të jetë burim konfliktesh dhe polarizimi ndërmjet gjeneratave, veçanërisht kur bëhet fjalë për dallime në shprehjet e përdorimit të teknologjisë apo pikëpamjet e ndryshme mbi përmbajtjen mediale (Clark, 2013). Gjeneratat e reja dhe të moshuarit mund të përjetojnë konflikte në lidhje me përdorimin e mediave digjitale, qasjen ndaj privatësisë ose ekspozimin ndaj rreziqeve online (Roberts & David, 2016). Fakti që ekziston një “hendek digjital” ndërmjet dy gjeneratave për arsye se kemi një gjeneratë e cila është e lindur dhe rritur në epokën digjitale (digital natives¹¹) dhe një tjetër që rishtazi po adaptohet me zhvillimet e mëdha teknologjike, gjithmonë e lë të hapur mundësinë e keqkuptimit dhe ngritjes së tensioneve në raport me sjelljen mediale që duhet ta ketë secili anëtar i familjes, hendek ky që është i aftë të i paraprijë ndikimit negativ në bashkëpunim dhe mirëkuptim familjar. Media gjithashtu mund të përforcojë stereotipat negative rreth dallimeve ndërmjet gjeneratave. Gjeneratat e reja shpesh portretizohen në media si të papërgjegjshëm, pa ambicie, joseriozë, persona që e kalojnë gjithë kohën e tyre në botën virtuale dhe të paafte për të marrë përgjegjësi apo për t’u besuar menaxhimi i çështjeve serioze. Ky portret medial i të rinjve, mund të ngjallë ndjenja negative tek gjenerata më e vjetër dhe të ndikojë në mënyrën se si ata i perceptojnë të rinjtë, duke krijuar në klimë mosbesimi dhe mosrespekti ndaj zgjedhjeve dhe mënyrës së tyre të jetesës, për faktin se ata i shohin të pa aftë për të marrë vendime, dhe për këtë qëllim vetë ofrohen për menaxhimin e jetës së tyre, gjë që bëhet shkak për konflikt ndërmjet gjeneratave.

Nga ana tjetër, gjeneratat më të vjetra, shpesh paraqiten në media si jo fleksibil, konservative, dhe me mungesë të aftësive teknologjike. Në shumë përmbajtje mediatike, si reklama apo seriale televizive, të moshuarit portretizohen si individë të ngadaltë në raport me botën teknologjike, kokëfortë gjatë

¹¹ Term që i referohet një personi të lindur ose rritur gjatë epokës së teknologjisë digjitale dhe i njohuar me kompjuterin dhe internetin që në moshë të re.

ndryshimeve dhe që e kanë të vështirë adaptimin me teknologjinë¹². Këto stereotipa e bëjnë brezin e vjetër të duket më pak i aftë për të kontribuar në diskutime dhe vendimmarrje rreth çështjeve teknologjike në familje. Kjo mund të përkthehet në diskriminim të butë dhe mungesë përfshirjeje të plotë të të moshuarve në vendime dhe aktivitete familjare që kërkojnë njohuri teknologjike ose adaptim me trendet e reja (Clark, 2013). Problematik tjetër e këtyre stereotipave mediale është edhe fakti se këto stereotipa mund të shndërrohen në pikëpamje gjenerale rreth një grupi të caktuar (gjenerate), dhe të bëhen shkak që të rinjtë të besojnë se ata vërtet janë të papërgjegjshëm, pa ambicie, joseriozë, persona që e kalojnë gjithë kohën e tyre në botën virtuale dhe të pa aftë për të marrë përgjegjësi apo për t'u besuar menaxhimi i çështjeve serioze, dhe në këtë mënyrë të fillojnë që kontributin (apo mos kontributin) e tyre social ta shohin nga ky prizëm, si dhe gjenerata e vjetër të i besoj stereotipit se janë të paaftë për t'u përshtatur me botën e re të teknologjisë dhe të vendosin të tërhiqen në vete apo të shprehin rebelimin e tyre përballë diskriminimit social. Për të reduktuar efektet negative të këtyre stereotipave, është shumë e rëndësishme që mediat të promovojnë përmbajtje të ekuilibruar dhe realiste, që theksojnë aftësitë, talentet dhe vlerat e çdo gjenerate. Përfaqësimi pozitiv dhe realist i grupeve të ndryshme ndërmjet gjeneratave mund të kontribuojë në krijimin e një mjedisi më të hapur dhe të respektueshëm, duke forcuar bashkëpunimin dhe mirëkuptimin brenda familjeve bashkëkohore.

Rëndësia e edukimit medial në familjet bashkëkohore

Ashtu siç e kemi cekur edhe më lartë, media luan një rol të rëndësishëm në përcjelljen e mesazheve sociale dhe ndërtimin e botëkuptimeve brenda familjes, prandaj, është e rëndësishme që medias t'i qasemi me një edukim medial të mirëfilltë, i cili do të na ndihmon që t'i kuptojmë më mirë mesazhet që na dërgohen dhe të dimë të bëjmë dallimin e stereotipave dhe realiteteve shoqërore. Edukimi medial (Media Literacy) është një qasje kritike dhe reflektuese ndaj përmbajtjeve mediatike, duke i pajisur individët me aftësi për të kuptuar, analizuar dhe vlerësuar mesazhet mediatike, për t'i përdorur ato në mënyrë aktive dhe të përgjegjshme, dhe për të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në jetën sociale¹³. Nëse marrim për bazë analizën e realizuar nga Open Society Institute Sofia¹⁴ e realizuar në vitin 2023, e cila është realizuar me 41 shtete të ndryshme dhe ka për qëllim analizën e potencialit të shoqërive për të lexuar drejtë mesazhet që i dërgohen nga media (siç janë: dezinformimi¹⁵ apo

¹² Clark, L. S. (2013). *The Parent App: Understanding Families in the Digital Age*. Oxford University Press.

¹³ Livingstone, S. (2004). *What is media literacy?* *Intermedia*, 32(3), 18-20.

¹⁴ https://osis.bg/?p=4450&utm_source=chatgpt.com&lang=en

¹⁵ Përmbajtje audio/vizuale, e fabrikuar ose manipuluar qëllimisht. Thashetheme ose teori të konspiracionit të krijuara me qëllim.

mosinformimi¹⁶) do të vërejmë se shtetet e zhvilluar si Finlanda (74 pikë nga 100 totali), Danimarka Finlanda (73 pikë nga 100), dhe Norvegjia (72 pikë nga 100), radhiten të parat me nivelin më të lartë të edukimit medial, ndërsa vendet në zhvillim si Gjeorgjia e cila është e fundit për nga renditja me vetëm 20 pikë, e paraprirë nga Kosova e cila gjendet në pozitën e 40 me 21 pikë dhe Maqedonia e Veriut në pozitën e 39 me 23 pikë, do të vërejmë se në mediat tona ekziston një nivel i lartë i rrezikshmërisë për manipulim mediatik, i cili bëhet shkak për ndërtimin e stereotipave dhe botëkuptimet e gabuara në shoqëri, e cila sjell deri tek ndarjet klasore e ndërmjet gjeneratave, të cilët mund të dërgojnë deri tek moskomunikimi i shëndoshë ndërmjet anëtarëve të familjes. Gjithashtu, në familjet ku ekziston një nivel i mirë i edukimit medial, komunikimi bëhet më i lehtë dhe më efektiv, pasi arrihet një mirëkuptim ndërmjet brezave më të vjetër dhe atyre më të rinj rreth mënyrës së funksionimit dhe ndikimit të mediave. Kjo jo vetëm që zvogëlon tensionet dhe konfliktet që mund të lindin nga dallimet në perceptime dhe qasje ndaj teknologjisë, por gjithashtu forcon lidhjet emocionale brenda familjes. Po ashtu, edukimi medial luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet online siq janë, bullizmi kibernetik ekspozimi ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme dhe manipulimet online, të cilat nëse nuk kanë një kujdes të mirëfilltë nga prindërit që posedojnë edukim të mirë medial duke monitoruar aktivitetet digjitale të fëmijës, duke vendosur kufijtë e duhur të përdorimit të rrjeteve sociale dhe duke i informuar mirë fëmijët rreth mundësive dhe dëmeve të botës digjitale, mundë të sjellin pasoja shumë të rrezikshme në gjendjen emocionale të fëmijës. Për më tepër, edukimi medial ndihmon në zhvillimin e një identiteti të shëndoshë familjar. Në kohën kur mediat sociale janë të mbushura me modele dhe stile jetese që shpesh janë të pavërteta ose të ekzagjeruara, aftësia për të kuptuar dhe analizuar këto mesazhe është shumë e rëndësishme për të ruajtur vetëbesimin dhe vetëvlerësimin e individëve brenda familjes. Përmes edukimit medial, familjet mund të zhvillojnë një qëndrim kritik ndaj standardeve të paraqitura në media dhe të shmangin ndikimin negativ të tyre në perceptimet personale dhe familjare.

Conclusion

In conclusion, the role of media in shaping family identity emerges as a complex and multidimensional phenomenon that significantly influences the structure, values, and intergenerational dynamics within modern families. The findings of this study reveal that both traditional and digital media have become powerful agents of socialization, not only reflecting but also actively shaping cultural norms and family behavior patterns. In particular, social

¹⁶ Gabime të paqëllimshme, siç janë tekstet e gabuara nën foto, të dhëna, statistika apo përkthime, ose kur satira merret për seriozisht.

media has profoundly transformed how families interact, perceive themselves, and represent their identities, influencing gender roles, parental authority, and interpersonal relationships.

While media provides opportunities to enhance communication and strengthen intergenerational bonds, it also carries considerable risks, including the reinforcement of stereotypes, intergenerational misunderstandings, and the creation of unrealistic expectations. Therefore, the need for comprehensive media literacy becomes essential in equipping families with the critical skills to differentiate between harmful media messages and those that contribute positively to individual and collective development.

Based on the analyses presented, it can be concluded that building a resilient family identity in the digital age requires heightened awareness of media influence, fair representation of family roles and dynamics, and a consistent commitment to promoting a healthy and inclusive media culture.

References:

- Babacan, G. (2016). Sosyal medya bağımlılığı. İstanbul: Çizgi Kitabevi.
- Blum-Ross, A., & Livingstone, S. (2017). Sharenting, parent blogging, and the boundaries of the digital self. *Popular Communication*, 15(2), 110–125.
- Clark, L. S. (2013). *The parent app: Understanding families in the digital age*. Oxford University Press.
- Duggan, M., & Smith, A. (2014). *Social media update 2013*. Pew Research Center.
- Ivan, L., & Fernández-Ardèvol, M. (2017). Older people and the use of ICTs to communicate with children: An analysis of Skype and WhatsApp. *Human Technology*, 13(2), 152–176.
- Papacharissi, Z. (2010). *A private sphere: Democracy in a digital age*. Polity Press.
- Roberts, J. A., & David, M. E. (2016). My life has become a major distraction from my cell phone: Partner phubbing and relationship satisfaction among romantic partners. *Computers in Human Behavior*, 54, 134–141.
- Steinberg, S. B. (2017). Sharenting: Children's privacy in the age of social media. *Emory Law Journal*, 66(4), 839–884.
- Open Society Institute – Sofia. (2023). *Media Literacy Index 2023: Double standards in a democracy*.